



TREGUESIT STATISTIKOR TË SHËRBIMEVE POSTARE

Tremujori III 2023

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Drejtoria e Tregjeve dhe Masave Rregullatore

Përmbajtje

I. HYRJE.....	3
II. PANORAMË E PËRGJITHSHME	3
III. PËRMBAJTJA E TË DHËNAVE.....	5
1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare.....	5
2. Treguesit e Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare	8
3. Treguesit e shërbimit jo universal postar	7
4. Treguesit e shërbimit ekspres	8

I . HYRJJE

AKEP, me qëllim informimin e palëve të interesuara me treguesit kryesore të tregut postar, sipas raportimeve të bëra nga Ofruesi i Shërbimit Universal Postar “Posta Shqiptare” sh.a. dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare ka përgatitur këtë raport në të cilin evidentohen treguesit kryesor të tregut postar për tremujorin e tretë të vitit 2023, si edhe krahasimet me tremujorin e dytë të vitit 2023 dhe me tremujorin e tretë të vitit 2022, i cili publikohet në faqen e internetit të AKEP www.akep.al, në seksionin “Statistika rreth AKEP” - “Shërbimet Postare”.

Raporti ka natyrë periodike dhe përditësohet vazhdimisht me të dhënat statistikore të shërbimeve postare.

II. PANORAMË E PËRGJITHSHME

Në këtë raport statistikor janë paraqitur të dhënat periodike statistikore të shërbimeve postare për tremujorin e tretë të vitit 2023 të dërguara nga Ofruesi i Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare të pajisur nga AKEP me “Autorizim të Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare”, në zbatim të kërkesave të Rregullores Nr.40, Datë 17.12.2015 “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga ofruesit e shërbimeve postare”.

Subjektet e pajisur nga AKEP me “Autorizim të Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare” të regjistruar në regjistrin e AKEP për periudhën e raportimit janë:

- **Ofruesi i Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare sh.a.**
- **Ofruesit e shërbimeve postare (30 subjekte):**
 1. Albanian Cargo Service sh.p.k. (A.C.S.)
 2. Albanian Delivery Express sh.p.k.
 3. ALOPOST sh.p.k.
 4. Balkan Courier & Logistics sh.p.k.
 5. BIPEX sh.p.k.
 6. Blendi Dokollari –Person Fizik (Flash Delivery Albania)
 7. DANDEX COURIER EXPRESS sh.p.k
 8. DHL International (Albania) sh.p.k.
 9. Elite Post sh.p.k.
 10. EXPRESS ALB 24 sh.p.k.
 11. GED sh.p.k. (ish B.E.D. sh.p.k.)
 12. GENIKI TAXYDROMIKI ALB sh.p.k
 13. Greenposta shpk
 14. INTEX COURIER sh.p.k.
 15. IPOST sh.p.k.
 16. Milsped Albania sh.p.k.
 17. Mr. COURIER sh.p.k.

18. POSTA JONË sh.p.k.
19. POSTMAN sh.p.k
20. T.N.T Express Albania sh.p.k.
21. Top Post sh.p.k.
22. Ultra C.E.P. sh.p.k.
23. Ulysses Enterprises sh.p.k.(Fedex)
24. United Transport sh.p.k. (Uni Trans)
25. Youth Albania Professional Services (YAPS)

Gjatë periudhës, nga tremujori i dytë i vitit 2023 deri në tremujorin e tretë të vitit 2023, ka 5 subjekte të çregjistruar për ofrimin e shërbimeve postare dhe kanë raportuar të dhënat statistikore 24 subjekte¹.

Posta Shqiptare me VKD Nr.13, datë 30.06.2020 është pajisur nga AKEP me Autorizim Individual për ofrimin e shërbimit universal postar.

¹ Ofrues të shërbimeve postare që kanë raportuar të dhënat statistikore në AKEP deri më datë 20.10.2023

III. PËRMBAJTJA E TË DHËNAVE

Të dhënat statistikore postare të dërguara nga ofruesit e shërbimeve postare përbajnë kryesisht:

1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare;
2. Treguesit e shërbimit universal postar;
3. Treguesit e shërbimit jo universal postar;
4. Treguesit e shërbimit ekspres.

1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2023 rezultojnë 5,455,424 objekte postare të pranuar dhe të dërguara nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare, të dhëna në mënyrë më të detajuar paraqiten si më poshtë vijon:

Tabela 1.1: Të dhëna përmblledhëse të objekteve postare sipas shërbimeve postare të ofruara

Shërbime postare të ofruara		T3_2022	T4_2022	T1_2023	T2_2023	T3_2023	Ndryshim T3_2023/ T2_2023	Ndryshim T3_2023/ T3_2022
Posta Shqiptare sh.a								
1	Shërbim Universal Postar							
1.1	Postë brenda vendit	5,001,676	5,906,952	5,351,099	3,679,866	4,098,479	11%	-18%
1.2	Postë ndërkombëtare	222,394	186,079	184,390	188,482	186,888	-1%	-16%
1.3	Totali 1.1+1.2	5,224,070	6,093,031	5,535,489	3,868,348	4,285,367	11%	-18%
2	Shërbim jouniversal postar							
2.1	Postë brenda vendit	106,925	101,500	92,252	164,019	72,173	-56%	-33%
2.2	Postë ndërkombëtare	431	449	146	631	532	-16%	23%
2.3	Totali 2.1+2.2	107,356	101,949	92,398	164,650	72,705	-56%	-32%
3	Shërbim ekspres							
3.1	Ekspres brenda vendit	119,412	124,731	126,129	126,802	129,033	2%	8%
3.2	Ekspres ndërkombëtar	4,340	3,411	3,883	3,954	1,329	-66%	-69%
3.3	Totali 3.1+3.2	123,752	128,142	130,012	130,756	130,362	-0.3%	5%
Ofruesit e tjerë të shërbimeve postare								
4	Shërbim JoUniversal Postar							
4.1	Postë brenda vendit	554,520	205,826	196,289	199,271	153,457	-23%	-72%
4.2	Postë ndërkombëtare	9,575	4,429	2,819	4,295	4,304	0.2%	-55%
4.3	Totali 4.1+4.2	564,095	210,255	199,108	203,566	157,761	-23%	-72%
5	Shërbim ekspres							
5.1	Ekspres brenda vendit	1,200,322	779,474	712,332	646,269	689,710	7%	-43%
5.2	Ekspres ndërkombëtar	58,120	93,927	63,387	104,757	119,519	14%	106%
5.3	Totali 5.1+5.2	1,258,442	873,401	775,719	751,026	809,229	8%	-36%
6	Totali 1.3+2.3.3.3+4.3+5.3	7,277,715	7,406,778	6,732,726	5,118,346	5,455,424	7%	-25%

Burimi: Ofruesit e shërbimeve postare. Përpunimi: AKEP

Në mënyrë të përmbledhur në vijim paraqiten disa nga zhvillimet kryesore në këtë treg:

Posta Shqiptare (Ofrues i Shërbimit Universal)

- ✓ **Shërbim universal postar.** Ky zë në total ka pësuar rënie në masën 18% nëse e krahasojmë me të njëjtën periudhë të vitit paraardhës dhe rritje në masën 11% krahasuar me 3 mujorin e mëparshëm T2 2023,. Edhe zëri **Postë brenda vendit** ka pasur një rënie krahasuar si me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm në masën 18%, dhe një rritje në masën 11% në krahasim me 3-mujorin e mëparshëm, ndërsa zëri **Postë Ndërkombëtare** ka një rënie nëse e krahasojmë me të njëjtën periudhë të një viti më parë në nivelin 16%, dhe në masën 1% krahasuar me 3-mujorin e mëparshëm T2 2023.
- ✓ **Shërbimi Jo universal postar.** Ky zë në total ka pësuar një rënie në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar në nivelin 32% dhe në nivelin 56% krahasuar me 3-mujorin e mëparshëm T2 2023. Në të njëjtat nivele është dhe **Postë brenda vendit**. Ndërsa zëri **Postë ndërkombëtare** ka një rënie me 16% nëse e krahasojmë me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar dhe një rritje me 23% krahasuar me 3-mujorin e mëparshëm T2 2023.
- ✓ **Shërbimi Ekspres** Ky zë në total ka pësuar rritje nëse e krahasojmë me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar në masën 5% dhe rënie në krahasim me 3-mujorin e mëparshëm T2 2023 në masën 0.3%. Ndërsa shërbimi **Ekspres brenda vendit** ka pasur rritje në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar në masën 8% dhe në masën 2% në krahasim me 3 mujorin e mëparshëm T2 2023, ndërkohë që **Ekspres Ndërkombëtar** ka pësuar rënie si krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar në masën 69%, po ashtu edhe me 3-mujorin e mëparshëm T2 2023 në masën 66%.

Ofruesit e tjerë të shërbimeve postare


- ✓ **Shërbimi Jo Universal Postar.** Ky zë ka një rënie në 3-mujorin e III 2023 në krahasim me 3-mujorin e II të 2023 në masën 23% dhe një rënie mjaft të ndjeshme në masën 72% në krahasim me 3-mujorin III të vitit të kaluar. Në të njëjtat nivele është dhe zëri **Postë brenda vendit**. Zëri **Postë ndërkombëtare** ka një rritje prej 0.2% në krahasim me 3-mujorin e mëparshëm T2 2023 dhe një rënie të konsiderueshme prej 55% në krahasim me 3-mujorin III të vitit të kaluar.
- ✓ **Shërbimi ekspres.** Ky zë ka pasur rritje në totalin e tij krahasuar me 3-mujorin e kaluar T2 2023 në masën 8%, dhe rënie në masen 36% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Zëri i shërbimit **Ekspres brenda vendit** ka një rritje prej 7% krahasuar me 3-mujorin e mëparshëm dhe një rënie në masën 43% krahasuar me vitin e kaluar. Ndërsa zëri i shërbimit **Ekspres ndërkombëtar** ka pasur nje rritje krahasuar si me 3-mujorin e mëparshëm T2 2023 ashtu edhe me të njëjtën periudhë të një viti më parë, përkatësisht në masat 14% dhe 106%.

Tabela 1.2: Totali i objekteve postare-Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare T3 2023

Totali i objekteve postare		
	Objekte postare	Pjesë tregu
<i>P.Sh</i>	4,488,434	82%
<i>Of. e tjerë</i>	966,990	18%
Totali	5,455,424	100%

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut

Grafiku 1.1: Totali i shërbimeve postare, krahasimi në 3-mujor



Burimi: Ofruesit e shërbimeve postare. Përpunimi: AKEP

Bazuar në të dhënat e paraqitura në grafikun 1.1 më sipër, shikojmë një rritje në objektet postare në T3_2023 krahasuar me T2_2023 si për Postën Shqiptare ashtu edhe për ofruesit e tjerë të shërbimeve postare. Gjithashtu, krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë kemi një rënie të totalit të objekteve postare si për Postën Shqiptare ashtu dhe për ofruesit e tjerë të shërbimeve postare.


Tabela 1.3: Totali i objekteve postare sipas llojeve të shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare T3_2023

Sh.U	Sh. jo univers.	Sh.ekspres	Totali
4,285,367	230,466	939,591	5,455,424
79%	4%	17%	100%

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut

Nga të dhënat e raportuara rezulton se volumin më të madh të objekteve postare e zë shërbimi universal postar me 79%, ndjekur nga shërbimi ekspres me 17% dhe shërbimi jo universal 4 %.

Grafiku 1.2: Ecuria në 3-mujor sipas llojeve të shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare



Burimi: Ofruesit e shërbimeve postare. Përpunimi: AKEP

Bazuar në të dhënat e paraqitura në grafikun 1.2, vërehet që pjesën më të madhe të shërbimeve postare e zë Shërbimi Universal Postar. Nga krahasimi i periudhës T3_2023 me periudhën T2_2023 vërehet që kemi një rritje në masën 7% në volumin total të shërbimeve postare. Ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë evidentohet një rënie në masën 25%.

2. Treguesit e Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare


Tabela 1.4: Shërbimi Universal Postar T3_2023

Shërbimi Universal Postar	
Postë brenda vendit	4,098,479
Postë ndërkombëtare	186,888
Totali	4,285,367

Burimi: Posta Shqiptare. Përpunimi: AKEP

Nga të dhënat e tabelës 1.4 për T3_2023, për sa i përket shërbimit Universal Postar, vihet re se Posta Shqiptare realizoi gjithsej 4,285,367 objekte, nga të cilat posta brenda vendit zë 96% të objekteve postare dhe posta ndërkombëtare zë 4% të objekteve postare. Për sa i përket Shërbimit Universal brenda vendit, janë regjistruar 3,327,967 shërbime për objekte të thjeshta dhe 770,512 shërbime për objekte të regjistruara/shërbime të veçanta. Në lidhje me Shërbimin Universal Postar Ndërkombëtar, janë regjistruar 37,563 objekte postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit dhe 149,325 objekte hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri.

Grafiku 1.3: Shërbimi universal postar - Ecuria në 3 mujor



Burimi: Posta Shqiptare. Përpunimi: AKEP

Nga grafiku i mësipërm, shikohet një rritje e shërbimit universal postar në T3_2023 krahasuar me T2_2023, me 11%.

3. Treguesit e totalit të shërbimeve postare - Posta Shqiptare

Në vijim paraqiten treguesit e realizimit të Shërbimeve Postare në total sipas zërave përkatës, të dërguara nga Posta Shqiptare:


Tabela 1.5: Treguesit e realizimit të Shërbimeve Postare në total sipas zërave përkatës, P. Sh

Llojet e shërbimeve	Nr. Objekteve	Pjesa tregut T_3 2023	Pjesa tregut T_3 2022
Shërbim universal postar	4,285,367	95.5%	95.8%
Shërbim jo universal postar	72,705	1.6%	2.0%
Shërbim ekspres	130,362	2.9%	2.3%

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut

Nga të dhënat e Tabelës 1.5 vihet re se volumin kryesor në shërbimet postare, që ofron Posta Shqiptare e zë shërbimi universal me 95.5%, i ndjekur nga shërbimi ekspres me 2.9% dhe nga shërbimi jo universal postar 1.6%. Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar kemi një rënie të vogël Shërbimit jo universal postar dhe rritje të Shërbimit ekspres.

Grafiku 1.4: Llojet e shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare – Ecuria në 3-mujor



Burimi: Posta Shqiptare. Përpunimi: AKEP

Grafiku 1.4 paraqet ecurinë e objekteve postare të Posta Shqiptare, ku vihet re një rritje e shërbimit universal dhe një rënie e atij jo universal dhe rënie dhe për shërbimin ekspres në T3_2023 krahasuar me T2_2023.

4. Treguesit e shërbimit jo universal postar – P.SH dhe Ofruesit e tjerë


Në vijim jepen të dhënat statistikore të marra së bashku për Postën Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare për shërbimin jo universal.

Tabela 1.6: Shërbimi jo universal postar (Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare)

Ofruesit	Nr. Objekteve	Pjesë tregu T3_2023	Pjesë tregu T3_2022
P.Sh	72,705	32%	16%
Of. e tjerë	157,761	68%	84%
Totali	230,466	100%	100%

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut

Grafiku 1.5: Shërbimi jo universal postar, Posta shqiptare/ofruesit e tjerë. Ecuria në 3-mujor



Burimi: Ofruesit e shërbimeve postare. Përpunimi: AKEP

Për sa i përket shërbimit jo universal, objektet postare të realizuara në T3_2023 krahasuar me T2_2023 kanë pasur rënie në total në masën 37% ku për Postën Shqiptare rënia është 56% ndërsa për ofruesit e tjerë të shërbimeve postare rënia është 23%

Numri i objekteve të shërbimit jo-universal postar për Postën Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare gjatë T3 2023 përbëhet nga 225,630 objekte brenda vendit dhe 4,836 objekte për shërbimin jo-universal jashtë vendit.

5. Treguesit e shërbimit ekspres - P.SH dhe Ofruesit e tjerë


Në vijim paraqitet informacion mbi treguesit e shërbimit postar ekspres për periudhën e tremujorit të tretë të vitit 2023, si edhe të dhënat për periudhat krahasuese për vitin 2022, mbi baza tremujore.

Tabela 1.7: Shërbimi ekspres-Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare për T3_2023

Ofruesit	Nr. Objekteve	Pjesë tregu T3_2023	Pjesë tregu T3_2022
P. Shqiptare	130,362	14%	9%
Of. e tjerë	809,229	86%	91%
Totali	939,591	100%	100%

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut

Grafik 1.6: Shërbimi ekspres - Posta shqiptare/ofruesit e tjerë, Ecuria në 3-mujor



Burimi: Ofruesit e shërbimeve postare. Përpunimi: AKEP

Shërbimi ekspres, gjatë T3_2023 ka pësuar rritje në krahasim me T2_2023 në masën 7% ndërsa në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar ka pësuar rënie në masën 32%. Duhet theksuar se ndikimin më të madh në këtë rënie e kanë Ofruesit e tjerë.

Shërbimi ekspres brenda vendit për Postën Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë së bashku është në vlerën 818,743 objekte postare ose 87% e totalit të këtij shërbimi, ndërsa shërbimi postar ekspres ndërkombëtar në vlerën 120,848 objekte postare ose 13% e totalit të këtij shërbimi për periudhën raportuese.

Për sa i përket postës ndërkombëtare në shërbimin ekspres, sasia e objekteve hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri është në vlerën 97,643 objekte dhe sasia e objekteve postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit është në vlerën 22,901 objekte.